



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Bazuar në dispozitat e nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 20 par.20.1 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, nenit 2 paragrafi 4 dhe neni 9 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43473 të datës 28.06.2019, Rregullores së Kuvendit të Komunës me Nr.15-110/04-11057 e datës 28.02.2023 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.-011-43473 e datës 28.06.2019 , Memorandumit të Bashkëpunimit të lidhur në mes të Organizatës "QATAR CHARITY" dhe Komunës së Lipjanit nr.01-352/07-66975 të datës 06.12.2023 dhe Aneks Marrëveshjes së Bashkëpunimit lidhur me hapjen e puseve për ujë të pijes Nr.01-016/01-37435 të datës 22.07.2025, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur me 31.03.2026, pas shqyrtimit të propozim Vendimit mori këtë:

## V E N D I M

### **PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE PËR ORGANIZATËN "QATAR CHARITY" PËR PROJEKTIN E HAPJES SË PUSEVE PËR UJË TË PIJES PËR FAMILJET ME KUSHTE TË RËNDA EKONOMIKE**

**I. MIRATOHET**, Vendimi për ndarjen e mjeteve financiare në shumë prej **29,489.40 €** (njëzet e nëntë mijë e katërqind e tetëdhjetë e nëntë euro e dyzet cent), Organizatës QATAR CHARITY", konform Memorandumit të Bashkëpunimit të lidhur në mes të Organizatës "QATAR CHARITY" dhe Komunës së Lipjanit nr.01-352/07-66975 të datës 06.12.2023 dhe Aneks Marrëveshjes së Bashkëpunimit lidhur me hapjen e puseve për ujë të pijes Nr.01-016/01-37435 të datës 22.07.2025

**II. Ndarja e mjeteve të cekura në pikën I të këtij Vendimi bëhet me qëllim të përmbushjes së obligimeve që rrjedhin nga dispozitat e Memorandumit të Bashkëpunimit të lidhur në mes të Organizatës "QATAR CHARITY" dhe Komunës së Lipjanit nr.01-352/07-66975 të datës 06.12.2023 , Aneks Marrëveshjes së Bashkëpunimit lidhur me hapjen e puseve për ujë të pijes Nr.01-016/01-37435 të datës 22.07.2025, bazuar edhe në Raportin mbi ecurinë e hapjes së bunareve në bashkëpunim me Komunën e Lipjanit Nr.12-320/01-36653 të datës 18.07.2025 për realizimin e projektit për hapjen e puseve për ujë të pijes në vende të ndryshme publike për familjet me kushte të rënda ekonomike në Komunën e Lipjanit ku 90% nga vlera e përgjithshme e projektit do të bashkëfinancohet nga Organizata "QATAR CHARITY" ndërsa 10 % do të bashkëfinancohet nga Komuna e Lipjanit.**

III. Shuma e mjeteve të cekura në pikën I të këtij Vendimi do të ndahet nga të hyrat vetanake të Komunës, kategoria ekonomike - subvencione dhe transfere të planifikuara për vitin 2026 për Drejtoratin për Bujqësi dhe Pylltari, kodi i programit 47003, fondi burimor 21/613/47003/200/00000/0421.

IV. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa, dhe Drejtorati për Bujqësi dhe Pylltari.

V. Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës.

Nr. 15-400/01-15242

Lipjan, më 31.03.2026

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

Kryesuesi i Kuvendit

Daut Azemi



*Daut Azemi*